




**REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO**  
**AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI-CORRUPTION AGENCY**

Dep.	2-0   DPK	Nr. Prot.	01-2979/15
Dep.		Bri Prot.	
Dep.		Prot No.	
Nr. Ifaq	03	Data	
Broj stranica		Datum	
Nr. pages		Date	30.09.2015
PRISHTINE			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**  
**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI – CORRUPTION AGENCY**

DATË/A:	30.09.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Artan Fejza Menaxheri Zyrës së Prokurimit në Komunën e Graçanicës
CC:	z. Valdeta Kostiq Kryetar i Komunës së Graçanicës
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI <i>H. Preteni</i> Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Renovimi dhe ndërtimi i rrugëve (asfaltimi), i rrjetit të kanalizimeve dhe ujësjellësit në komunën e Graçanicës"



Inderuari z. Fejza,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korruptionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me tenderin " Renovimi dhe ndërtimi i rrugëve (asfaltimi), i rrjetit të kanalizimeve dhe ujësjellësit në komunën e Graçanicës" me numër prokurimi: GRA-618 15 057 511, Agjencia kundër Korruptionit ofron këtë:

### O P I N I O N

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejshmë A.K), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin " Renovimi dhe ndërtimi i rrugëve (asfaltimi), i rrjetit të kanalizimeve dhe ujësjellësit në komunën e Graçanicës" në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

## A r s y e t i m

Zyra e Prokurimit në Komunën e Graçanicës ka përgatitë Njoftimin për Kontratë me titull

**"Renovimi dhe ndërtimi i rrugëve (asfaltimi), i rrjetit të kanalizimeve dhe ujësjellësit në komunën e Graçanicës"** me numër prokurimi: GRA-618 15 057 511, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt. 17.09.2015, në Procedurë të Hapur. Divizioni për Parandalimin e Korruptionit në Prokurimin Publik, pranë Agjencisë Kundër Korruptionit sipas detyrës zyrtare ka identifikuar këtë procedurë prokurimi si rast për trajtim. Gjatë ekzaminimit të dokumentacionit të kësaj procedure të prokurimit, Agjencia Kundër Korruptionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në pajtueshmëri të plotë me dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Graçanicës ka parapa që përmes këtij aktiviteti të prokurimi të bëjë lidhjen e një kontrate Publike Kornizë për 36 muaj. Sipas LPP kontrata publike kornizë është term i përgjithshëm i marrëveshjeve në mes të autoriteteve kontraktuese si dhe operatorëve ekonomik për furnizime, shërbime, dhe punë (**riparim/punë mirëmbajtje**), e cila i vendosë termat dhe kushtet sipas të cilave kontratat ndihmëse ose bërja e urdhrale mund të kryhet përmes termave të marrëveshjes.

Autoriteti Kontraktues duhet të gjykoj nëse kontrata kornizë publike është qasja më e mirë për prokurimin përkatës. Kjo do të përfshijë gjykime për nxjerrjen e vlerës së parasë së dhënë duke marr parasysh natyrën e prokurimit si dhe aftësinë që të specifikoj prokurimin me përpikëri të mjaftueshme qysh në fillim autoriteti kontraktues nuk mund ta përdor kontratat publike kornizë në mënyrë të tillë që të parandaloj, kuqizoj, ose ngatërroj konkurrencën.

Po ashtu AKK gjatë shfletimit të Dosjes së Tenderit për këtë aktivitet të prokurimit ka konstatuar se në pjesën e **paramasës** dhe **parallogarisë** Autoriteti Kontraktues nuk ka parapa një sasi të përafërt të punëve dhe furnizimeve që do të realizohen në këtë aktivitet të prokurimit, por te gjitha pozicionet janë të plotësuar me numrin një (1), gjë që nuk parashikon një vlerë të përafërt. Bazuar në Rregulloren për Prokurim Publik Autoriteti Kontraktues duhet të specifikoj sasitë gjatë përgatitjes së materialit tenderues, po ashtu në rast të aplikimit të kontratës kornizë ku sasia mund të mos jenë e parashikuara në mënyrë precize, duhet të bëhet një parashikim i përafërt i sasive.

Agjencia Kundër Korruptionit pasi ka analizuar me kujdes paramasën dhe parallogarinë për këtë aktivitet të prokurimit ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues në disa pjesë të paramasës dhe parallogarisë ka paraparë edhe pozicione që kanë të bëjnë me mbjelljen e fidanëve si dhe pozicione tjera që kanë të bëjnë me sinjalizimin horizontal dhe vertikal. AKK konsideron se natyra e tillë e punëve dhe furnizime kërkon zhvillim të aktiviteteve të ndara pasi që për kryerjen e këtyre furnizimeve dhe shërbimeve nevojiten Operatorë Ekonomik të profileve përkatëse.



Autoriteti Kontraktues gjegjësisht njësia e kërkesës duhet ti kushtoj një rëndësi të veçantë hartimit të para masës dhe para llogarisë për aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë ndërtimore si në këtë rast ku kemi të bëjmë me ndërtim të rrugëve, ndërtim të ujësjellësit dhe kanalizimit ku duhet qartë të precizohen të gjitha pozicionet e punëve, furnizimeve dhe shërbimeve që do të realizohen gjatë ekzekutimit të kontratës për këtë aktivitet të prokurimit, ndërsa në këtë rast mënyra se si autoriteti kontraktues ka bërë hartimin e paramasës është fare e pa qartë se **cilat rrugë do të asfaltohen, sa është gjatësia e tyre, sa është gjatësia e ujësjellësit dhe kanalizimit që do të ndërtohet si dhe në cilat territorë do të bëhet riparimi i tyre.**

Po ashtu Autoriteti Kontraktues i ka përfshirë në një aktivitet të vetëm të gjitha punët, në bazë të titullit të tenderit shihet qartë se kemi të bëjmë me renovim, ndërtim të rrugëve, ujësjellësit dhe kanalizimit, e që do të duhej të ishin si aktivitet të ndara të prokurimit, e jo të përfshihen në një aktivitet të vetëm. Kjo ndërlidhet edhe me faktin se hartimi kërkesave minimale për kualifikim (përshtatshmëria, profesionaliteti, kërkesat teknike dhe financiare) si dhe kriteret për dhënie të kontratës duhet përpiluar ne pajtueshmëri me natyrën e aktivitetit të prokurimit.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura më lartë, konsiderojmë se bien ndesh me Nenin **15** Klasifikimi i kontratave të Përziera, Nenin **27** Dosja e Tenderit, nenin **28** Specifikimet teknike të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/I.-042 se dhe nenin **9** Funksionet e Njësisë së Kërkesës të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.

P. KOSOVA

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj AKK rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!